

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Misin Frangu, me zyrtaren ligjore Ibadete Qerimi, në çështjen juridiko-kontestimore të inicuar me padinë e paditëses Kompania e Sigurimeve [REDACTED] Prishtinë, [REDACTED] kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED], për kompensim dëmi, jashtë seance me datë 10.03.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M
-PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË / MOSBINDJES-

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve [REDACTED] Prishtinë, [REDACTED]

DETYROHET i padituri [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED] që paditëses të i'a paguan shumën prej 413,00 €, me kamat ligjore nga dita e parashtrimit të padis në këtë gjykatë, për pagesë së dëmit prej dt. 18.01.2016, deri në pagesen definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

OBLIGOHET paditësi që të paguan taksën gjyqësore për padi dhe aktgjykim, në shumë prej 30.00 €, menjëher pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësja, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit, me pretendimin se për shkak të veprimeve deliktore të paditurit gjatë pjesëmarrjes në komunikacion, ka shkaktuar aksident trafiku dhe ka shkaktuar dëm materiale për të cilat paditësja është detyruar që ta kompensoj të dëmtuarin [REDACTED]

Gjykatës i kanë bashkangjitur provat dhe dëshmitë tjera material, nga aksidenti i trafikut.

Gjykata, të paditurit, me datë 29.02.2016, në pajtim të nenit 394 të LPK-së, i ka dorëzuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditëses, por i padituri brenda afatit të caktuar ligjor, me aktvendimin për dhënjen e përgjigjes në padi, nuk ka ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e tij nëse e kundërshton apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nga provat e çështjes ka gjetur se themelësia e kërkesëpadsisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja, si dhe duke pasur parasysh faktin se i padituri ka pranuar me rregull padine me prova dhe aktvendimin për përgjigje në padi (ku nga fletë kthesa konstatohet se e njejta i është dorëzuar më dt.29.02.2016), i cili dorëzimi konsiderohet se është pranuar në mënyrë të rregulltë, gjykata bazuar në nenin 150.6, të LPK-së ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjyqësore.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 të LPK-së, që përjashton mundësin për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamaten ka vendosur në bazë të nenit 277 të LMD-së, duke qenë se për paditësin lartësia e dëmit dhe shkaktuesi i saj, kanë qenë të përcaktuar që në kohën e ngritjes së padisë.

Gjykata ka obliguar të paditurën për kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në bazë të nenit 452.1 të LPK-së, ndërsa paditësin në bazë të UA nr.2008/2 të KGJK-se, për unifikimin e taksave gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
C.nr.65/16, me datë 10.03.2017



Gjyqtari,
sin Frangu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar të kërkesa në afat prej 15 ditësh në gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Afati fillon nga dita e nesërme e pranimit të këtij aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KO...

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

04 2017

